

RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË KONKURISIT

“VLERA E VËRTETË E PARASË”

Në përpjekjen e saj për edukimin e publikut në fushën e bankingut qendror, ekonomisë, dhe financës, Banka e Shqipërisë, nën shembullin edhe të bankave qendrore të vendeve më të zhvilluara, duke filluar që prej vitit shkollor 2007-2008, organizon një konkurs të përvitshëm me nxënësit e shkollave të mesme të qyteteve të ndryshme të Shqipërisë. Konkursi, është një prej aktiviteteve të përfshira në Memorandumin e Bashkëpunimit, të nënshkruar midis Ministrisë së Arsimit dhe Bankës së Shqipërisë në datën 13 dhjetor 2007. Memorandum, i cili ka për qëllim nxitjen dhe bashkërendimin e veprimtarive të të dy institucioneve në fushën e edukimit.

Për herë të parë, Banka e Shqipërisë e organizoi këtë aktivitet vetëm për qytetin e Tiranës. Gjatë këtij viti dhe atyre të ardhshëm është vendosur që konkursi të zhvillohet edhe në rrethe të tjera, duke u përmbyllur me një finale të zhvilluar me skuadrat fituese të secilit prej tyre.

Tema e konkursit lidhet me funksionin kryesor të Bankës Qendrore, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe hartimin e zbatimit të politikës monetare të saj, duke synuar në këtë mënyrë të thellë njohuritë e nxënësve në këtë fushë.

Është zgjedhur kjo grupmoshë, pasi në programin mësimor që zhvillohet në shkollat e mesme është përfshirë lënda me njohuritë bazë mbi ekonominë, pikërisht në klasën e tretë të shkollës së mesme.

Konkursi “Vlera e Vërtetë e Parasë” është një sfidë midis ekipeve të shkollave të mesme të një rrethi mbi njohuritë e tyre për Bankën e Shqipërisë, politikën monetare të saj dhe instrumenteve që ajo përdor, si dhe ndikimin që ajo ka në ekonominë e vendit. Sfidë do të ketë formën e një konkursi klasik, ku skuadrat do t’u përgjigjen pyetjeve të një paneli jurie të ngritur nga Banka e Shqipërisë dhe do të gjykojnë jo vetëm mbi njohuritë e tyre, por edhe mbi aftësitë analitike të argumentimit të përgjigjeve dhe punës në grup.

Me organizimin e një konkursi të tillë Banka e Shqipërisë synon të njohë nxënësit dhe mësuesit e shkollave të mesme me funksionet e Bankës së Shqipërisë dhe me ndikimin që ajo ka në ekonominë e vendit. Përveç synimit kryesor organizimi i këtij aktiviteti ka për qëllim të nxisë interesin e brezit të ri në lëndën e ekonomisë, biznesit dhe financës, si drejtime për studime universitare dhe pasuniversitare dhe një pedanë kërcimi drejt një karriere dhe kontributi të suksesshëm në këto fusha.

SHPLLJA DHE KRITERET E PJESËMARRJES

Shkollat pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas parimit të zhvillimit të programit të njëjtë mësimor për lëndën e ekonomisë. Nxënësit pjesëmarrës duhet të përzgjidhen prej mësuesve të lëndës së ekonomisë dhe nxënësve të shkollës që ata do të përfaqësojnë. Ekipet duhet të përbëhen prej tre nxënësish që ndjekin vitin e tretë gjimnaz, të cilët do të drejtohen prej mësuesit të lëndës së ekonomisë së zbatuar.

Emrat e nxënësve pjesëmarrës do t'i komunikohen Bankës së Shqipërisë nga shkollat pjesëmarrëse.

MATERIALI DHE PYETJET

Grupi i materialeve që duhet studiuar për përgatitjen për konkurs do të shpërndahet nga Banka e Shqipërisë tek të gjithë mësuesit e shkollave pjesëmarrëse. Materiali do të përgatitet dhe përshtatet prej grupit të punës, të formuar posaçërisht për këtë aktivitet. Pyetjet dhe temat e konkursit do të përgatiten nga grupi i punës së këtij aktiviteti.

NJOFTIMI ZYRTAR

Konkursi do të zhvillohet në disa rrethe të vendit në datën dhe orën e përcaktuar paraprakisht nga Banka e Shqipërisë. Secila shkollë do të marrë njoftim të veçantë për datën dhe orën e saktë të zhvillimit të konkursit të saj, pas hedhjes së shortit zyrtar në Drejtorinë Arsimore të rrethit përkatës.

FAZA PARAPËRGATITORE DHE KONTAKTI ME BANKËN

Gjatë fazës parapërgatitore ekipeve do t'u komunikohen një ose dy data (në varësi të numrit të shkollave pjesëmarrëse) në të cilat do të mund të takohen me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, për të sqaruar çdo pyetje mbi materialin e studimit. Ekipet do të mund të kontaktojnë çdo ditë pune me një përfaqësues të grupit të punës së konkursit, nëpërmjet një numri kontakti me bankën: +355-(0)4-2222152, numër i brendshëm 2270 ose 4200 dhe adresës elektronike public@bankofalbania.org.

RREGULLAT PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT

I. KONKURSI “VLERA E VËRTETË E PARASË”, NË RANG RRETHI

Të gjitha skuadrat pjesëmarrëse do të lajmërohen nga Banka e Shqipërisë për datën, orën dhe vendin në të cilin do të zhvillohet konkursi, në rrethin e tyre.

Konkursi do të zhvillohet në **1 ditë me 2 raunde të njëpasnjëshme eliminatore**, ku një numër i caktuar ekipesh nga shkolla të ndryshme do të konkurrojnë në një tryezë të rrumbullakët, drejtuar nga paneli i jurisë. Për të vendosur se ekipet e cilave shkolla do të përballen me njëra-tjetrën gjatë konkursit në rang rrethi do të hidhet një short në praninë e përfaqësuesve të Drejtorisë Arsimore të rrethit dhe të Bankës së Shqipërisë. Ekipet gjatë zhvillimit të konkursit duhet të kenë nga një shenjë dalluese të shkollës që do të përfaqësojnë (në formën e veshjes, stemave, kapeleve etj.).

Skuadrat kanë të drejtë të shoqërohen prej një grupi mbështetësish, numri i të cilëve do të përcaktohet në varësi të sallës, ku do të zhvillohet aktiviteti.

RAUNDI I PARË

Në raundin e parë të konkursit skuadrat i nënshtrohen pyetjeve sipas llojeve të mëposhtme të tyre:

LLOJET E PYETJEVE:

Ekipet pjesëmarrëse në konkurs do t'u përgjigjen 4 llojeve të ndryshme pyetjesh:

1. Pyetje rrufe.

Çdo ekipi do t'i drejtohen 5 pyetje, përgjigja e të cilave është e shkurtër dhe duhet dhënë në harkun e 10 sekondave. Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë, ndërkohë që për çdo përgjigje të gabuar vlerësimi është -1. **Vlerësimi maksimal 15 pikë.**

2. Pyetje quiz me 4 alternativa.

Çdo ekipi do t'i drejtohen 4 pyetje, përgjigja e saktë e të cilave gjendet në njërin nga alternativat që do të jepen nga organizatorët e konkursit. Gjetja e alternativës së saktë do të vlerësohet me 6 pikë, ndërkohë që për çdo përgjigje të gabuar vlerësimi është -3 pikë. Në rast se skuadra nuk ka një përgjigje, vlerësimi është 0 pikë. **Vlerësimi maksimal 24 pikë.**

3. Pyetje me plotësim termash.

Çdo ekipi do t'i jepen 2 paragrafë. Në secilin prej tyre do të ketë një mungesë prej 2 fjalësh, të cilat duhen të gjenden dhe të plotësohen. Vlerësimi për përgjigjen e saktë për një fjali është 8 pikë (4 pikë për çdo term). **Vlerësimi maksimal 16 pikë.**

4. Pyetje me shtjellim.

Ekipteve do t'u vihen në dispozicion 10 minuta kohë për të shkruar përgjigjen dhe 3 minuta për ta prezantuar atë përpara panelit të jurisë. Një përgjigje e saktë dhe e plotë do të vlerësohet me 25 pikë. **Vlerësimi maksimal 25 pikë.**

Në raundin e parë, ekipi mund të grumbullojë gjithsej **80 pikë** për të gjitha përgjigjet e sakta.

SHPLLJA FITUES TË RAUNDIT TË PARË

Ekipet do të renditen sipas pikëve të grumbulluara, në një vendosje të përgjithshme të të gjithë pjesëmarrësve. Ky listim do të bëhet publik në përfundim të raundit të parë të Konkursit, në rang rrethi. **Tre skuadrat që kanë grumbulluar numrin më të lartë të pikëve, do të kualifikohen për në raundin e dytë të konkursit.**

RAUNDI I DYTË

Në raundin e dytë të konkursit skuadrat e kualifikuara si më sipër do t'i nënshtrohen pyetjeve sipas llojeve të mëposhtme të tyre:

LLOJET E PYETJEVE:

Ekipet pjesëmarrëse në konkurs do t'u përgjigjen 3 llojeve të ndryshme pyetjesh:

1. Zgjidhje ushtrimi.

Çdo ekipi do t'i jepet një ushtrim për llogaritjen e një treguesi apo të një ndryshimi në një apo disa tregues. Ekipet do të kenë në dispozicion 10 minuta kohë për të

përgatitur dhe shkruar përgjigjen. Një përgjigje saktë dhe e plotë do të vlerësohet me 40 pikë. **Vlerësimi maksimal 40 pikë**

2. Interpretim i një grafiku.

Ekipeve do të kenë në dispozicion një grafik për të cilën skuadrat duhen të bëjnë interpretimin në formë analize. Ekipeve do t'u vihen në dispozicion 5 minuta kohë për të përgatitur dhe shkruar përgjigjen. Një përgjigje saktë dhe e plotë do të vlerësohet me 20 pikë. **Vlerësimi maksimal 20 pikë**

3. Pyetje me shtjellim.

Ekipeve do t'u vihen në dispozicion 10 minuta kohë për të shkruar përgjigjen dhe 3 minuta për ta prezantuar atë përpara panelit të jurisë. Një përgjigje saktë dhe e plotë do të vlerësohet me 40 pikë. **Vlerësimi maksimal 40 pikë.**

Gjithsej ekipi mund të grumbullojë **100 pikë** për të gjitha përgjigjet e sakta të konkursit në raundin e dytë.

SHPALLJA FITUES NË RANG RRETHI DHE KUALIFIKIMI PËR NË FAZËN FINALE

Ekipeve konkurruese në raundin e dytë, ashtu si veprohet në përfundim të raundit të parë, do të renditen sipas pikëve të grumbulluara. Renditja e 3 skuadrave sipas pikëve të fituara do të bëhet publike në përfundim të konkursit. Sipas kësaj renditjeje përfundimtare ekipet do të përfitojnë çmimet përkatëse dhe skuadra e cila ka grumbulluar më shumë pikë do të kualifikohet si përfaqësuese e rrethit të saj në finalen që do të zhvillohet në fund të vitit shkollor.

II. KONKURSI FINAL

Në konkursin final ekipet fituese në rang rrethi do të përballen me pyetje të po të njëjtës natyrë si dhe do t'u duhet të mbajnë një prezantim të shkurtër mbi një temë, e cila do t'i bëhet e njohur ekipeve finaliste dy javë para takimit final. Edhe kjo fazë e konkursit do të paraprihet nga **një fazë parapërgatitore**, si në rastin e Konkursit në rang rrethi. Nxënësit do të kenë 10 minuta kohë për të bërë prezantimin e temës. Një prezantim i plotë dhe i saktë i argumentit do të vlerësohet me 40 pikë. **Vlerësimi maksimal 40 pikë.**

Pyetjet e tjera, përveç prezantimit do të jenë si më poshtë:

2. Pyetje quiz me 4 alternativa.

Çdo ekipi do t'i drejtohen 3 pyetje, përgjigjja e saktë e të cilave gjendet në njërin nga alternativat që do të jepen nga organizatorët e konkursit. Gjetja e alternativës së saktë do të vlerësohet me 6 pikë, ndërkohë që për çdo përgjigje të gabuar vlerësimi është -3 pikë. Në rast se skuadra nuk ka një përgjigje vlerësimi është me 0 pikë. **Vlerësimi maksimal 18 pikë**

3. Pyetje rrufe.

Çdo ekipi do t'i drejtohen 4 pyetje, përgjigjja e të cilave është e shkurtër dhe duhet dhënë në harkun e 10 sekondave. Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë,

ndërkohë që për çdo përgjigje të gabuar vlerësimi është -1. **Vlerësimi maksimal 12 pikë**

4. Zgjidhje ushtrimi.

Çdo ekipi do t'i jepet një ushtrim për llogaritjen e një treguesi apo të një ndryshimi në një apo disa tregues. Ekipeve do t'u vihen në dispozicion 10 minuta kohë për të përgatitur dhe shkruar përgjigjen. Një përgjigje saktë dhe e plotë do të vlerësohet me 20 pikë. **Vlerësimi maksimal 20 pikë**

5. Pyetje e anasjelltë.

Çdo ekip duhet të përgatisë dhe të drejtojë një pyetje për njërën nga skuadrat kundërshtarë. Pyetja duhet të ketë lidhje me materialin e vënë në dispozicion nga organizatorët. Pyetja dhe përgjigja e saktë e saj i vihen në dispozicion jurisë së konkursit ditën e zhvillimit të tij, një orë para orës zyrtare të fillimit të konkursit. Në letrën e pyetjes duhet të shënohet emri i shkollës, pyetja dhe përgjigja e saktë. Ekipeve do t'u vihen në dispozicion 3 minuta kohë për të përgatitur përgjigjen. **Vlerësimi maksimal 10 pikë**

Gjithsej ekipi mund të grumbullojë **100 pikë** për të gjitha përgjigjet e sakta të konkursit.

Finalja e konkursit “Vlera e Vërtetë e Parasë” do të zhvillohet në fund të vitit mësimor 2008-2009, në qytetin e Tiranës, si edhe do të filmohet e transmetohet në njërin prej televizioneve kombëtare të vendit.

III. JURIA DHE ETIKA

1. Paneli i jurisë përbëhet nga drejtues të Bankës së Shqipërisë.
2. Pjesëtarët e jurisë kanë të drejtë të komunikojnë me ekipet gjatë zhvillimit të konkursit, sa herë që e gjejnë të arsyeshme.
3. Ekipet marrin fjalën vetëm kur ajo i drejtohet nga juria.
4. Pjesëtarët e ekipeve nuk kanë të drejtë të: ndërpresin fjalën e kundërshtarit, të ofendojnë kundërshtarin gjatë konkursit, të komunikojnë me publikun, t'i drejtohen jurisë kur nuk i është dhënë fjala.
5. Mbështetësit e ekipeve nuk duhet të pengojnë mbarëvajtjen e konkursit dhe punën e panelit të jurisë, duke shkaktuar zhurmë në sallë apo duke ofenduar kundërshtarët.

IV. KOHA DHE VENDI I ZHVILLIMIT TË KONKURSIT

Koha dhe vendi i zhvillimit të konkursit në rang rrethi dhe atij final do t'u komunikohen shkollave të mesme pjesëmarrëse në konkurs nga Banka e Shqipërisë.

V. ÇMIMET

1. Çmimet e skuadrave fituese në rang rrethi:

Fituesve të këtij konkursi do t'u shpërndahen këto çmime:

1. Vendit të parë - 3 kompjutera laptop (me vlerë 100 000 lekë secili);
2. Vendit të dytë - 3 kompjutera laptop (me vlerë 78 000 lekë secili);
3. Vendit të tretë - 3 aparate fotografikë dixhitalë (me vlerë 52 000 lekë secili).

2. Çmimet individuale

Çmimet individuale u jepen tre nxënësve që gjatë zhvillimit të të gjitha fazave të konkursit kanë dëshmuar bashkëpunimin më të mirë në skuadër, kanë treguar nivel të lartë të përgatitjes, qartësi në dhënien e përgjigjeve dhe arsyetim analitik. Çmimet janë në formën e objekteve të cilat ngjallin kuriozitetin, ndjenjën artistike dhe argëtojnë të rinjtë. Vlera monetare e tyre është 26 000 lekë.

3. Çmimi për punën më të mirë në grup

Ky çmim i jepet skuadrës e cila ka punuar më mirë në grup. Si në rastin e çmimeve individuale edhe këto çmime janë objekte të cilat ngjallin kuriozitetin, ndjenjën artistike dhe argëtojnë të rinjtë. Vlera monetare e tyre është 26 000 lekë.

4. Çmimi i finales:

Secilit prej pjesëtarëve të skuadrës fituese, do t'i çelet një depozitë bankare prej 100.000 lekësh në një prej bankave tregtare të zgjedhura prej tyre. Kjo depozitë do të mund të përdoret prej tyre vetëm pas përfundimit të shkollës së mesme.

VI. FESTA PËRMBYLLËSE

Pas përfundimit të këtij aktiviteti për çdo rreth, të gjithë pjesëmarrësit do të ftohen të marrin pjesë në një festë - koktej, të organizuar enkas për ta.